-------- Mensaje original --------
Asunto: Fwd: Answers on your request
Fecha: Tue, 06 Aug 2013 20:34:48 +0200
De: Morgane Access Info [redacted]access-info.eu>
Para: Lydia Medland [redacted] ccess-info.org>

-------- Mensaje original --------
Asunto: Answers on your request
Fecha: Thu, 7 Mar 2013 15:09:25 +0100

Respected Mr. Morgane;

Below you will find the official answers from Kosovo Police in albanian language. The same answers you will receive in english language tomorow.
With respect;

Përgjigjja për pyetjen 1

Baza legale për intervenim të Policisë së Kosovës është:Ligji mbi Tubimet Publike, Nr. 03/02-118, Ligji i Policisë së Republikës së Kosovës, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës dhe Koncepti Kosovar për Ballafaqim me Turma (në këtë koncept janë të parapara të gjitha teknikat e veprimit dhe arrestimit etj,)

Përgjigjja për pyetjen 2

Në situata të trazirave të dhunshme por edhe në të gjitha rastet kur kemi prishje të rendit dhe qetësisë publike, policia përdorë mjetet e veta të cilat i ka në dispozicion në përputhje me aktet normative në fuqi.

Prej mjeteve për përdorimin e forcës Njësitë Speciale të Policisë së Kosovës kanë në dispozicion: shkopin e polikarbonatit, sprejin OC grupor dhe individual, topin e ujit, gazin lotsjellës, mburojën dhe natyrisht edhe armët e zjarrit nëse situata e caktuar e vë në rrezik proporcional të drejtpërdrejtë apo indirekt policin apo rrezikon jetën e qytetareve.

Për të gjitha këto mjete të gjithë policët e njësive speciale kanë trajnimet e nevojshme në përputhje me standardet më të larta demokratike të vendeve të BE-së.

Përgjigjja për pyetjen 3

Policia e Kosovës posedon numër të mjaftueshëm të pajisjeve policore të lartpërmendura për njësitet speciale, numër ky i cili mbetet i ditur për nevoja të brendshme.

Njësitë Speciale sipas nevojës dhe ballafaqimit me situata të ndryshme brenda 5 vjetëve kanë përdorur pajisjet si: shkopin e polikarbonatit, sprejin OC grupor dhe individual, topin e ujit, gazin lotsjellës, mburojën bazuar ne ligje dhe rregullore sa herë që detyrimisht është paraqitur nevoja.

Armët e zjarrit nuk janë përdorur asnjëherë deri më tash.

Përgjigjja për pyetjen 4

Për të gjitha këto mjete të gjithë policët e njësive speciale kanë kryer trajnimet e nevojshme në përputhje me standardet më të larta demokratike të vendeve të BE-së.

Forca përdoret në përputhje me aktet normative në fuqi, është cekur edhe në pikën 1 të këtij dokumenti dhe të gjitha teknikat e përdorimit të forcës janë të parapara edhe në trajnimet e vazhdueshme, të cilat janë në plan-programet e Departamentit të Trajnimeve të Policisë së Republikës së Kosovës dhe Konceptit Kosovar për Ballafaqim me turma.

Sa i përket kërkesës rreth posedimit të dokumenteve, ju lutem referojuni ueb faqes së Kuvendit të Republikës së Kosovës ku janë publike të gjitha ligjet në fuqi.

Përgjigjja për pyetjen 5

Njësitet policore duke përfshirë edhe Njësitë Speciale të Policisë së Kosovës përpilojnë raporte zyrtare pas çdo operacioni dhe analizohen veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë.

Zyra për informim dhe marrëdhënie me publikun - ZIMP
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë - Prishtinë

Tel. [redacted]

Email: [redacted] kosovopolice.com
www.kosovopolice.com

From: Morgane Access Info [redacted] access-info.eu]
Sent: Wed 2/13/2013 12:55 PM
To: Zyra Informimit DPP
Cc: Lydia Medland
Subject: Request for Information

Dear Sir or Madam,

Please find attached a request for information to the police forces.

Should you have any further questions, do not hesitate to contact me.

Kind regards,

Morgane

--
Morgane Dussud
Researcher, Human Rights
Access Info Europe
[redacted]
www.access-info.org/en